**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 30.3.2023 | Nr: 221 | Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, nenit 103, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S:**

1. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të prodhohen 10% (520 copë) vula rezervë të KQV-së.
2. Teksti i vulës rezervë të KQV-së është unik për çdo vulë dhe përbëhet nga shkronja "R" dhe një numër serial katër shifror.
3. Formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Dorëzimi i vulës dokumentohet nëpërmjet procesverbalit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Formati i Vulës: KQV - REZERVË**




**Legjenda:**

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit, tekst: REZERVË, R-0000/01
7. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

MODEL

# Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 14 maj 2023

# PROCESVERBAL KZAZ - KQV

## Për dorëzimin në KQV të vulës rezervë

| KZAZ Nr: | | KQV | | Datë: | | Ora: | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|

**Baza Ligjore:** Neni 103, pika i ligjit 10 019, datë 29.12.2008 ' Kodi Zgjedhor I Republikës Së Shqipërisë' i ndryshuar

| | Ekzemplari i vulës së KQV-së rezervë |
|---|---|
| Sot më datë ..... ..... ......, në qendrën e votimit nr. ............ , ZAZ ............, Qarku ..............................., u dorëzua **vula rezervë** me numrin e identifikimit .................. **REZERVË**<br><br>Kjo vulë do të përdoret për të zëvendësuar vulën e nxjerrë jashtë përdorimit të:<br><br>☐ **Vulës së KQV-së**<br><br>☐ **Vulës së kryetarit të KQV-së** | Vula |

| Dorëzuesi nga KQZ / KZAZ | Marrësi në Dorëzim nga KQV |
|---|---|
| _______________ (emër, mbiemër, firmë) | **Kryetar:** _______________ (emër, mbiemër, firmë)<br><br>**Sekretar:** _______________ (emër, mbiemër, firmë) |

Vula